

DOKUMENT PËRMBLEDHËS I KUSHTEVE TË SIGURIMIT – KLIENTËT ROAMING TË ONE

Masa maksimale e mbulimit: 7,000 Euro/udhëtim

ÇFARË MBULOHE	KUSH SIGUROHET	PROCEDURA NË RAST DËMI	ÇFARË MBULOHE	KUSH SIGUROHET	PROCEDURA NË RAST DËMI
SIGURIM NË UDHËTIM			SIGURIM PRONE		
Shpenzimet mjekësore emergjente jashtë Shqipërisë për sëmundje apo aksidente të papritura. Riatdhesimi i personit të siguruar në rast emergjence shëndetësore. Përqindja e rimbursimit sipas shumës së dëmit:	Në rast sigurimi individual, sigurohet personi që autorizon transferimin e të dhënave personale me qëllim krijimin e sigurimit, pasi aktivizohet paketa roaming. Në rast sigurimi familjar, sigurohen edhe anëtarët e familjes. Pra, ata që përfitojnë janë: bashkëshorti/bashkëshortja dhe fëmijët që udhëtojnë së bashku me të siguruarin, i cili ka autorizuar transferimin e të dhënave personale tek kompania e sigurimit, me qëllim krijimin e sigurimit. Nëse nuk autorizohet transferimi i të dhënave, sigurimi nuk mund të ofrohet!	Njoftoni SIGAL brenda 48 orëve nëse ka shtrim në spital. Mblidhni dokumentacionin origjinal të shpenzimeve (raporte mjekësore, fatura, receta). Dorëzoheni dokumentacionin për rimbursim ose kërkoni autorizim paraprak në rast se kërkohet pagesë direkte nga SIGAL.	Dëmtime të papritura dhe të rastësishme si rezultat i: Zjarrit ; Rrufeve, Shpërthimeve, Tërmeteve mbi 4 shkallë Richter.	Apartamenti i mbuluar duhet të jetë ai i regjistruar ose i marrë me qira (me kontratë) në emrin e personit që ka aktivizuar roaming-un.	Njoftoni menjëherë SIGAL, brenda 48 orëve nga ngjarja. Informoni policinë apo zjarrfikëset nëse është e aplikueshme. Mos prekni vendngjarjen derisa të vijë eksperti. Bëni listën e dëmeve dhe dokumentoni gjithçka me foto, fatura, vlerësime. Prisni vlerësimin dhe miratimin nga kompania para rikthimit apo riparimit të pronës.
Deri në 200 Euro – 100%					
201 – 1,000 Euro – 90%					
1,001 – 2,000 Euro – 80%					
Mbi 2,001 Euro – 70%					

POLICAT E OFRUARA:

1. Sigurim i Shëndetit në Udhëtim – Emergjencë Mjekësore & Riatdhesim
2. Sigurim Prone – Zjarr & Tërmet
3. Shërbim Telemjekësie – Konsultë mjekësore 24/7

MBULIMI TOTAL:

- **Limiti maksimal i mbulimit:** 7,000 Euro për të gjithë periudhën e sigurimit dhe të gjitha ngjarjet së bashku
- **Zonë mbulimi:** Jashtë territorit të Shqipërisë për sigurimin e udhëtimit; territori i Republikës së Shqipërisë për sigurimin e pronës

1. SIGURIM SHËNDETI NË UDHËTIM

Çfarë mbulohet:

- Shpenzimet mjekësore emergjente jashtë Shqipërisë për sëmundje apo aksidente të papritura
- Riatdhesimi i personit të siguar në rast emergjence shëndetësore

Përqindja e rimbursimit sipas shumës së dëmit:

- Deri në 200 Euro – 100%
- 201 – 1,000 Euro – 90%
- 1,001 – 2,000 Euro – 80%
- Mbi 2,001 Euro – 70%

PËRKUFIZIME DHE KLAUZOLA TË RËNDËSISHME:

- Sëmundje e papritur: çfarëdo përkeqësim i menjëhershëm i shëndetit që kërkon trajtim urgjent
- Aksident: ngjarje e papritur me ndikim të jashtëm, të dhunshëm dhe të identifikueshëm
- Riatdhesim: transportimi i të siguarit në Shqipëri për shkak të pamundësisë për të vijuar trajtimin jashtë

Përjashtime kryesore:

- Shpenzimet nga personat e pasiguar: konsiderohen të tilla ata klientë roaming që nuk autorizojnë transferimin e të dhënave tek SIGAL
- Shpenzime në Shqipëri
- Trajtim për sëmundje ekzistuese
- Përdorimi i drogave, alkoolit apo veprime të qëllimshme
- Sporte të rrezikshme, vetëdëmtime, AIDS
- Trajtime dentare (përveç emergjencave deri në 100 Euro)
- Mbi moshën 69 vjeç (pa policë të posaçme)
- Sigurimi nuk është i vlefshëm nëse numri One që ka përfituar paketën nuk është regjistruar në emrin e kërkuarit të rimbursimit.
- Nuk përfitohet sigurimi i pronës nëse numri i telefonit One dhe shtëpia nuk janë në të njëjtën pronësi.

2. SIGURIMI I PRONËS (Zjarr dhe Tërmet)**Çfarë mbulohet:**

- Dëmtime të papritura dhe të rastësishme si rezultat i:
 - Zjarrit

- Rrufeve
- Shpërthimeve
- Tërmeteve mbi 4 shkallë Richter

Vlera e kompensimit:

- Në bazë të vlerës së zëvendësimit të pronës ose sipas dëmtimit real

Përfashtime kryesore:

- Shpenzimet nga personat e pa siguruar, konsiderohen te tille ata kliente roaming qe nuk autorizojne transferimin e te dhenave tek SIGAL
- Dëme nga luftë, trazira, greva, sabotime, terrorizëm
- Dëme të qëllimshme ose nga pakujdesia e vetë të siguruarit
- Mungesë dokumentacioni ose mosnjohim në kohë
- Nën apo mbisigurim (kompensimi do të rregullohet në përpjestim)
- Dëmtime nga nxehtësia funksionale (ngrohës, kaldaja etj.) pa përhapje zjarri
- Dëmtime elektrike nga mbingarkesë apo defekte teknike, përveç rasteve që shkaktojnë zjarr
- Dëmtime të pajisjeve të brendshme elektrike nga rrufeja indirekte
- Dëme që lidhen me armë bërthamore, ndotje radioaktive apo veprime të qëllimshme

Përkufizime të rëndësishme për këtë sigurim:

- **Zjarri:** Djegie me flakë që ndodh jashtë një hapësire të kontrolluar dhe që ka tendencë për t'u përhapur.
- **Tërmeti:** Lëkundje të tokës të konfirmuara nga stacionet sizmike me magnitudë mbi 4 shkallë të Rihterit.
- **Rrufeja:** Goditje e drejtpërdrejtë nga rrufeja mbi një objekt të siguruar.
- **Shpërthim:** Çlirim i menjëhershëm i energjisë nga gazra ose avuj të cilët zgjerohen me forcë, duke shkaktuar dëmtim fizik.
- **Vlera e zëvendësimit:** Kostoja e rindërtimit ose rikthimit të objektit në gjendjen e mëparshme duke përdorur materiale dhe teknologji aktuale.
- **Nën-sigurimi:** Kur shuma e siguruar është më e ulët se vlera reale e objektit – kompensimi bëhet proporcional.

3. SHËRBYM TELEMJEKËSOR – TELESHËNDET

Çfarë ofrohet:

- Konsultime shëndetësore 24/7 në distancë (video/telefon)

- Shërbime për veten ose për anëtarët e familjes (nëse janë përfshirë në plan)

Përdorimi:

- Akses përmes aplikacionit ose linjës telefonike të dedikuar

Kufizime:

- Nuk zëvendëson emergjencën mjekësore – në raste urgjente duhet të thërrisni 127
- Nuk trajtohen raste të rënda apo që kërkojnë ndërhyrje fizike të menjëherëshme

Hapat për aktivizim të Teleshëndet (abonim prove – 15 ditë):

1. **Regjistrohuni** në platformën Teleshëndet (përmes aplikacionit në Play Store ose App Store)
2. Hyni në seksionin **“Profili Im”**
3. Zgjidhni opsionin **“Aktivizo Abonimin Provë”** për të përfituar nga shërbimet për 15 ditë;

Detyrime të të Siguruarit:

- Njoftimi i siguresit brenda 48 orëve në rast hospitalizimi
- Dorëzimi i dokumentacionit origjinal të dëmit
- Parandalimi i dëmeve kur është e mundur

E Drejta për Ankesë:

- Ankesat mund të paraqiten me shkrim ose elektronikisht pranë SIGAL ose pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF)